



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E ARSIMIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE
DREJTORIA E PROVIMEVE TË SHTETIT**

Nr. 5815/10 Prot.

Tiranë, më 04.12.2025

URDHËR

Nr. 831, Datë 04.12.2025,

PËR

**NJË SHITESË NË KALENDARIN E PROVIMIT TË DIGJITALIZUAR PËR
PUNËSIMIN SI TEKNIK TË SHKENCAVE MJEKËSORE
DHJETOR 2025**

Në mbështetje të Ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009 "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të Urdhrit nr. 365, datë 28.12.2020 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për miratimin e Rregullores "Për funksionimin e Komisionit të Provimit të Shtetit dhe procedurat e zhvillimit të Provimit të Shtetit", e ndryshuar, të kërkesës së Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor nr. 3806 prot., datë 04.11.2025 me lëndë "Kërkesë për kryerje testim i informatizuar – TSHM – Portali "Infermier për Shqipërinë"", të shkresës së Ministrisë së Arsimit nr. 7214/2 prot., datë 19.11.2025 me lëndë "Kthim përgjigje", si dhe të shkresës së Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor nr. 4175 prot., datë 03.12.2025 me lëndë "Për disa shtesa në listën emërore të profesionistëve të shkencave mjekësore teknike për zhvillimin e testimit të informatizuar",

URDHËROJ:

Zhvillimin e disa seancave shtesë në kalendarin nr. 5815 prot., datë 27.11.2025 të organizimit të provimit të digjitalizuar të kandidatëve për t'u punësuar, si teknik të shkencave mjekësore, në profesionet: Infermieri, Mami, Fizioterapi, Logopedi, Teknik Imazherie dhe Teknik Laboratori, në datat 06.12.2025 dhe 13.12.2025.

Ngarkohet për zbatimin e këtij Urdhri, Drejtoria e Provimeve të Shtetit, duke marrë të gjitha masat për organizimin dhe zhvillimin e seancave të provimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Aida Myrto